



# VULLNETI I MIRË



# SUKSESI I SIGURT

## LIRIA, JETA JONË

TONE (14), EDISA (11), BLERTA (12), HAJDIN (11), DREN (11), SUELA (11)



Ti mund të mbështetësh në mua. Së bashku mund të arrijmë qëllimet tona!

### Çdo njeri duhet të jetë tolerant dhe të respektoj të tjerët. Por, a e bëjnë të gjithë këtë? Mbetet të shihet më poshtë

Sistemi i qeverisjes në bazë të të cilit jemi duke jetuar ne, qytetarët e Republikës së Kosovës quhet demokraci. Ky sistem karakterizohet me disa elemente që i japin vlerë dhe kuptim jetës sonë. Pa to, jeta do të ishte shumë e vështirë dhe jo e rregullt. Jeta jonë është e rregullt në demokraci, sepse çdo njeri ka të drejtë të ketë mendime të lira dhe të veproj i/e lirë. Kjo arrihet gjithmonë në përputhje me ligjin. Këto elemente, për të cilat jemi duke diskutuar janë: liria, respekti, toleranca, solidariteti, etj. Elementet në fjalë janë të zbatuara nga ne dhe nga rrethi ku ne jetojmë. Me këtë kuptojmë se në komunat e Kosovës promovohen vlerat demokratike. Shembull të tillë e kemi Komunën e Prizrenit, ku toleranca mbizotëron në një nivel të kënaqshëm.

Për shembull, toleranca ndër-fetare është mjaft e the-

ksuar në vendin në fjalë. Me rritjen e tolerancës ndër-fetare është arritur edhe harmonia mes njerëzve. Prandaj, Prizreni përveç që është i njohur si vend historik, ai është vend mjaft tërheqës për të gjithë qytetarët dhe vizitorët e vendeve të tjera. Kjo edhe shihet nga fytyrat e qeshura dhe të ndritura të qytetarëve.

Andaj, ne ndihemi shumë krenarë që jemi pjesë e këtij vendi. Për këtë arsye, çdo herë jemi duke provuar të bëhemi shembull i qytetarëve të përgjegjshëm dhe të zellshëm. Vetëm me aktivizim qytetar sigurojmë mirëqenie sociale. Për të arritur të jemi shembull i mirë, duhet që t'i ndajmë informatat që i kemi me njëri-tjetrin dhe duhet që të marrim mendimin e secilit. Qëllimi i kësaj është të arrijmë një bashkëpunim të suksesshëm. Mundësinë për t'i bërë të gjitha këto e kemi në shtetin tonë demokratik. Veçse, na takon neve që të aktivizohemi dhe t'i zbatojmë të gjitha përgjegjësitë që në takojnë si qytetarë. Se cilat janë këto përgjegjësi, vazhdoni të lexoni artikullin vijues.



Të lumtur që kemi të drejta të shumta



Gazetarët aktiv të Kosovës

## VULLNETI I MIRË, E ARDHME E NDRITUR

Tërë diskutimin tonë në Punëtorinë e Demokracisë „Demos-ti“ e filluam me fjalën vullnet. Kjo fjalë është aq e rëndësishme për ne, sa që mendojmë që nëse e bëjmë një punë me vullnet të madh do të arrijmë sukses. Andaj, themi se asgjë nuk është e paarritshme. Mjafton pak vullnet dhe humanizëm për t'i dhënë ngjyrë dhe jetë punës dhe veprimeve pozitive që dëshirojmë t'i bëjmë

Entuziazmin tonë për fjalën vullnet, duam ta lidhim edhe me qytetarinë aktive. Asnjë qytetar nuk mund të realizoj asgjë të madhe, pa e përjetuar këtë koncept dhe pa e ditur rëndësinë e saj. Kjo sidomos vlen për qytetarët aktiv, të cilët nga humanizmi dhe vullneti që kanë, arrijnë të bëjnë ndryshme të mëdha në nivel shoqëror. Këtë mund ta ndërlikim me disa iniciativa që ata i ndërmarrin. Shembull, ne vetë marrim pjesë në OJQ të ndryshme, pastrojmë ambientin ku jetojmë dhe ndihmojmë të tjerët. Gjatë gjithë jetës sonë, kemi shumë raste kur jemi treguar qytetarë të denjë. Janë veprimet tona ato të cilat na bëjnë aktiv. Ne vetë kemi vendosur se kush do të jetë pjesë e Parlamentit të shkollës sonë, përmes votave të nxënësve. Kjo dëshmon faktin se ne me votat tona jemi bërë pjesë e vendimmarrjes.



Shteti ndërtohet nga qytetarët aktiv. Prandaj, ne kemi zgjedhur të jemi të tillë




Ne mund të lexojmë se si mund të bëhemi edhe më aktiv



Qytetarë aktiv jemi të gjithë, pa dallim aftësive tona



Bashkimi i ideve tona bën ndryshime të duhura



Të bashkuar, arrijmë t'i realizojmë qëllimet e përbashkëta

## NE, POPULLI ZGJEDHIM PËR VETEN TONË

ANDI (11), LORETA (11), LUKA (11), SUMEJA (11), ANDA (13), ARLIND (11)



Edhe pse ne jemi fëmijë, zgjedhjet për ne janë shumë të rëndësishme, sepse udhëheqësit e mirë kanë fuqi të na zbukurojnë jetën dhe të ardhmen tonë

**Nëse keni pasur gjithmonë dëshirë të mësoni për zgjedhjet, keni ardhur në vendin e duhur. Ky artikull, i punuar nga ne, flet pikërisht për këtë temë**

Mirëseerdhët në artikullin tonë. Të gjitha fjalitë që do t'i lexoni janë të shkruara nga nxënësit e klasës VI-1. Sot mësuam për zgjedhjet. Ne thamë se në Kosovë kemi dy lloje të zgjedhjeve. Ato janë: zgjedhjet komunale ose lokale dhe zgjedhjet parlamentare ose qendrore. Këto zgjedhje, me rregull, mbahen një herë në 4 vjet. Në zgjedhjet komunale ose lokale, ne zgjedhim kryetarin e komunës dhe asamblenë. Kurse, përmes zgjedhjeve parlamentare ose qendrore, zgjedhen deputetët e Kuvendit të Kosovës. Në Kuvend kemi 120 deputetë, të cilët konsiderohen përfaqësues të popullit. Nga ta 30% duhet të jenë gra. Për shkak se në Kosovë kemi banore gra dhe vajza, në Kuvend duhet të kemi edhe gra deputete. 100 deputetë janë shqiptarë, kurse 10 janë serbë e 10 të tjerë janë turq, goranë, boshnjakë,

ashkali, egjiptianë dhe romë. Ne meritojmë të kemi deputetë të mirë, të cilët duhet të jenë të ditur dhe të cilët e duan popullin e vet. Deputetët duhet t'i mbajnë premtimet e dhëna dhe duhet të jenë punëtorë. Ata duhet të kujdesen për popullin dhe duhet të jenë të përgjegjshëm në punën e tyre. Edhe pse deputetët mund të kenë etni të ndryshme, kjo nuk ka rëndësi. Rëndësi ka nëse janë të ndershëm dhe nëse punojnë për të mirën e vendit. Ne kemi dy mënyra të votimeve: votimi i hapur dhe votimi i mbyllur. Këto dy forma të votimeve i kemi përdorur edhe në jetën e përditshme. Por, tani do të flasim për votimin e mbyllur.

Unë jam Anda dhe jam pjesë e këshillit të shkollës sime. Një ditë prej ditësh, në një mbledhje të këtij këshilli, vendosëm të votonim për kryetarin/en e shkollës i/e cila do të udhëheq me shumë gjëra që kanë lidhje me shkollën. Ky rol është shumë i rëndësishëm, pasi që kryetari i shkollës do të na përfaqësoj të gjithë nxënësit të shkollës. Për këtë detyrë, votuam në mënyrë të mbyllur. Nga dy kandidatët më të mirë të të gjithë shkollës, ne duhej të zgjedhim kandidatin më të mirë. Emrat e tyre ishin të shënuar në një letër të vogël. Secili nga anëtarët e këshillit mori një nga këto letra. Në to, ne patëm për detyrë të shënojmë cilin kandidat menduam se është më i miri për të udhëhequr shkollën. Si rezultat, Donika mori më shumë vota, prandaj ajo u zgjodh kryetare e shkollës. Kjo do të thotë se edhe fëmijët mund dhe kanë të drejtë të zgjedhin në jetën e tyre.



Ne punën tonë e bëjmë me plot dashuri

# DEPUTETËT PLOTËSOJNË KËRKESAT TONA

GRESA (11), SAMUEL (11), ALBULENA (11), QËNDRIM (11), DANIELLA (12)



Para ligjit, të gjithë jemi të barabartë pa asnjë dallim. E sidomos, pa dallime gjinore!

## Institucioni në të cilin ne kemi besim të madh është Kuvendi, sepse aty merren vendimet për të ardhmen tonë

Në Kosovë, fatmirësisht, kemi shumë njerëz të shëndetshëm, të cilët kanë kushte të mira për jetesë. Në Kosovë, gjithashtu, ka shumë organizata humanitare, siç janë: „Nëna Terezë“, „Kryqi i Kuq“, etj. Por, ne po ashtu kemi edhe njerëz me nevoja të veçanta, të cilët nuk mund të punojnë e të fitojnë para. Ata marrin ndihma sociale nga shteti i tyre. Mirëpo, me ato para, ata nuk mund të krijojnë vendstrehim për veten e tyre. Prandaj, ne kërkojmë nga përfaqësuesit tanë t'i ndihmojnë këta persona.

Në Kosovë, për fat të keq, kemi edhe njerëz me sëmundje të ndryshme. Për ta kuruar një sëmundje të rëndë, siç është kanceri, nevojitet një shumë e madhe parash. Një qytetar i Kosovës, me pagën që e merr,

nuk ka mundësi ta paguaj atë shumë të parave, edhe nëse përfiton nga ndihma sociale. Andaj, ne kërkojmë nga deputetët e Kuvendit të Kosovës të marrin masa për këtë çështje. Nëse realizohet kjo, ne do të ishim shumë më të lumtur.

Institucioni, të cilin e cekëm pak më lart, pra Kuvendi, është institucion në të cilin punojnë 120 deputetë. Këta deputetë i zgjedhim ne qytetarët, me anë të votave. Ata kanë disa detyra. E para është përfaqësimi i popullit, meqenëse ne i votojmë ata. Detyrë tjetër është të miratojnë apo të mos miratojnë ligje, si dhe detyra e tretë është ta kontrollojnë punën të cilën e bën Qeveria. Ne e kuptuam që Kuvendi është shumë i rëndësishëm, për vetë faktin se aty punojnë deputetët, të cilët flasin në emrin tonë. Është mirë të dijmë më shumë për Kuvendin dhe deputetët, sepse ata mendojnë për të ardhmen tonë.



Nëse ne i thejmë ligjet, atëherë ne ndëshkohemi



Të lumtur me përfaqësimin e shtetit tonë



## IMPRESUM



Ky publikim është produkt i punës së pjesëmarrësve të projektit „Demos-ti“ i cili realizohet nga



REPUBLIKA E KOSOVËS / KUVENDI  
REPUBLIKA KOSOVA / SKUPŠTINA  
REPUBLIC OF KOSOVO / ASSEMBLY

i implementuar nga



Projekti është mundësuar dhe përkrahur nga



**ERSTE Stiftung**

Redaktohet nga  
Kuvendi i Kosovës

Qëllimi i publikimit  
Edukimi qytetar nëpërmes metodave edukative joformale

shtypur nga  
TOKA

Na kontaktoni për të marrë pjesë: Pjesëmarrësit:  
Tel: +381 38 704 560 SHFMU „Lidhja e Prizrenit“  
E-mail: info@demos-ti.org Klasa: VI-1  
Website: www.demos-ti.org Vendi: Prizren